

## NEWSLETTER 1



**Ky projekt synon** veprime konkrete për forcimin e kohezionit territorial, nëpërmjet mundësive të bashkëpunimit në logistikë, njohurive më të mirë të mundësive të transportit dhe logistikës në zonën e Evropës Juglindore, një politikë të re dhe të përbashkët për lëvizjen modale dhe mbrojtjen e mjedisit, dhe shërbimeve inovative transporti të bazuara në korridore .

Pritshmeritë e Friuli Venezia Giulia, si partner lider, janë për të krijuar komunitetin ADB si një grup partnerësh territorialë, industrialë dhe shkencorë me detyrë zhvillimin e koncepteve të ADB.

Bashkëpunimi mes partnerëve heterogjene dhe trans-nacionale sjell përfitime të përbashkëta për aktorët e përfshirë në projekt dhe con në arritjen e rezultateve të përbashkëta në projekt, të tilla si zbatimi i **mjeteve të përbashkëta ICT** për monitorimin e shërbimeve të transportit, krijimin e **Rrjeteve Cilesore të Korridoreve** , **Qendrat e Zhvillimit multimodal**, një **marrëveshje të përbashkët mbi masat e internalizimit të kostove të eksternaliteteve**, si dhe zhvillimin e shërbimeve të transportit të bazuara në korridore.

Gjatë vitit të parë është realizuar procesi i përgatitjes së projektit. Është bërë një punë e madhe ndërmjet partnerëve. Kjo ishte një punë e madhe për shkak të

origjinave të ndryshme gjeografike (vendet e BE-së dhe jo të BE-së) dhe natyrës heterogjene të partnerëve (publike, private, Universitete, etj).

Një rezultat i rëndësishëm i arritur është evidentimi i të dhënave dhe rezultateve të arritura nga partnerë të ndryshëm në projektin e mëparshme.



Ndër të tjera, në vitin 2013, pjesa e parë e projektit iu dedikua studimeve dhe punës përgatitore për implementimin. Në veçanti, të gjithë studimet e shërbimeve të transportit, infrastrukturës dhe skenarët e trafikut do të kompletohen dhe do të krijohet një "bazë ADB" e përbashkët. Për më tepër, implementimi i ICT tools do të jetë në hapat e parë. Një moment historik kyç i vitit 2013 ishte pjesëmarrja e ADB në "Transportin Logjistik 2013", panairin e famshëm në Mynih. Dy ëorkshope u realizuan nga partnerët e ADB më 4 dhe 5 Qershor.

### Takimet dhe Komunikimi i Projektit

Projekti pati hapjen e tij zyrtare në Trieste, në shtator 2012, kur projekti iu paraqit për herë të parë grupeve të interesit dhe shtypit. Takimet e mëtejshme drejtuese (PSC) u mbajtën në **Budapest** (Nëntor 2012), në **Beograd** (Janar 2013) dhe në **Konstanca** (Maj



2013). Të gjitha takimet janë përdorur për të koordinuar partnerët e ndryshëm dhe aktivitetet e projektit. Në këto takime janë përfshirë gjithashtu edhe konferencat për shtyp.



Faqja e internetit e projektit është [www.adbmultiplatform.eu](http://www.adbmultiplatform.eu) dhe të rehat mbi projektin mund të ndiqen gjithashtu edhe në faqen e Facebook, ([www.facebook.com/adbmultiplatformproject](https://www.facebook.com/adbmultiplatformproject)).

Komunikimi i Projektit bazohet në Planin e Komunikimit dhe të Shpërndarjes së informacionit, i cili është përpunuar gjatë periudhës së parë të projektit.



### **Nyjet dhe infrastruktura në zonën Adriatik-Danub-Deti Zi:**

Rrjetet e Korridoreve Cilesore do të përcaktohen në mënyrë që të krijohet një hartë e shërbimeve ekzistuese të infrastrukturës për transportin intermodal dhe multimodal në zonën e ADB.

Krijimi i rrjeteve cilësore të Korridoreve (CQN) do të jetë rezultati përfundimtar, dhe qëllimi përfundimtar i aktiviteteve: studime cilësore dhe performancës së terminaleve në zonën ADB; studim i standardeve dhe procedurave; do të jenë pjesë e punës.

Do të krijohet një tablo e plotë e mundësive, pengesave, dhe do të propozohen masa për një cilësi më të mirë dhe ndërveprim në transportin e mallrave.

CQN do të përfshijë lojtarë kyç aktivë ose të interesuar në transportin multimodal në korridoret e zgjedhur brenda zonës ADB dhe do të jenë të dizenuar si një zgjidhje inovative dhe efektive për "menaxhimin e Korridorit", sipas një modeli të hapur dhe fleksibël, duke ruajtur dhe përmirësuar marrëdhëniet e biznesit midis partnerëve.

Aktivitetet do të zhvillohen sipas planit të aktiviteteve të planifikuara me partnerët e përfshirë në grupin 3 të punës, gjatë takimeve të zhvilluara. Duke pasur parasysh këtë, është përfunduar një /studim i përgjithshëm që përmbledh informacionet nga projektet e kaluara dhe nga projektet në vazhdim në lidhje me transportin e mallrave në rajonin / brenda të cilave identifikohen projektet (e kaluara dhe në vazhdim si: GIFT, KREM, DAHAR, ĘATERMODE, SETA, SEETAC dhe të tjera) në të gjithë korridoret e zgjedhura të projektit ADB.



**"Shtylla kryesore ICT e platformës multimodale ADB "** përmban një total prej pesë aktivitete kryesore që çojnë në qëllimin final të zhvillimit dhe zbatimit të mjeteve ICT si komponentë të platformës multimodale ADB.

Tre fazat e projektuara që sigurojnë inputet e nevojshme të kërkuara për realizimin e disa ICT tools janë: studimi i state of art i sistemit të informacionit të Lumenjve; nevoja për harmonizim në vendet brenda ADB; harmonizimi i procedurave doganore.

Të gjitha rezultatet e këtyre tre aktivitete paraqesin bazën për realizimin e fazes së katërt, dmth zbatimin e ICT tools pilot, ku do të zhvillohen: sistemi i gjurmimit për trenat e mallrave; harmonizimi i Sistemeve Doganore të Menaxhimit, duke përfshirë mjetet për menaxhimin e dokumenteve të ngarkesave të automatizuara; harmonizimi i RIS dhe aplikimi për qënder zhvillimi multimodal.

Një seminar teknik në lidhje me " ICT-ne e platformës multimodale ADB ", u mbajt në Tetor 2012 në Sofje, ku partnerët shkëmbyen ide dhe diskutuan për implementime të mundshme të pilot tools dhe për të koordinuar zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve përkatëse.

**Qendrat e Zhvillimit Multimodal** do të implementohen në vendet partnere të projektit. Qendrat e Zhvillimit Multimodal, bazuar në modelet ekzistuese të suksesshme (KIP-it në Kroaci, Agjencive Rajonale Italiane, etj) do të përforcojnë promovimin e multimodalitetit.


Projekti do të përcaktojë vendndodhjen e Qendrave përgjatë korridoreve pilote, planin e biznesit dhe grupet e interesit të përfshira. Koncepti i Qendrave do të integrojë të gjithë elementet e "praktikave më të mira" të përvojave për promovimin e transportit intermodal, dhe ndjekë udhëzime të qarta të përbashkëta për zbatimin, për aktivitetet që do të kryhen, për të siguruar një bashkëpunim real me karakter transnacional.

**"ADB dhe Transporti i Gjelbër"** ka të bëjë më aktivitete, për ta bërë

transportin e mallrave në zonën e Evropës Juglindore "te gjelbër" . Kostot e eksternaliteteve, dmth kostoja e ndotjes së ajrit, ndryshimi i klimës, aksidentet etj, nuk paguhen aktualisht nga përdoruesit e infrastrukturës.

Pjesa e projektit e lidhur me këtë çështje, shqyrton metodat dhe mjetet për llogaritjen në të ardhmen të internalizimit të kostove të eksternaliteteve, e cila do të conte në mbrojtjen e mjedisit.

Do të promovohet një „marrëveshje per transportin e gjelbër” për angazhimin politik në internalizimit te kostove te eksternaliteteve. Gjithashtu, do të zhvillohet një metodologji e përbashkët për vlerësimin e ndikimeve mjedisore të veprimeve të parashikuara në ADB, si dhe një program i përbashkët trajnimi për qëllime arsimore.



Source: EEA, also available at Eurostat (online data code: tadco210)

*EU-27 greenhouse gas emissions by source sector 2009*

[www.adbmultiplatform.eu](http://www.adbmultiplatform.eu)

[www.facebook.com/adbmultiplatformproject](https://www.facebook.com/adbmultiplatformproject)

